



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 43 Prot

Tiranë, më 14.10 2011

VENDIM Nr. 7 dt. 06.10.2011

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 06.10.2011, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

VENDOSI:

Lidhur me projektet e shqyrtuara në mbledhjen e KKR dt. 06.10.2011

1. **Miratohet:** Projekt përshtatje ambientet e ish Kinostudios Shqipëria e re. Projektimi i laboratorëve të konservimit të objekteve të trashëgimisë kulturore.
2. **Miratohet:** Ndërhyrje emergjente (ekstreme), për shkulljen dhe transportimin pranë laboratorit të IMK të afreskut në bazilikën e Elbasanit.

Projektet, sipas kërkesave të qytetarëve:

1. **Miratohet:** Projekt rikonstruksioni e shtesë banese 2 katëshe me pronar Romeo Zallemi, lagja nr. 12, rruga Qemal Stafa, Korçë.
2. **Nuk miratohet:** Projekt i objektit tregtar dhe banim 3 kate me podrum, investitor Nikollaq Riza, bulevard "Republika", Korçë. **Të diskutohet në mbledhjen e radhës, pasi Këshilli Shkencor, të shohë reflektimin e vërejtjeve.**
3. **Nuk miratohet:** Projekt rikonstruksion banese e shtesë kati, investitor Tefta Bala, lagja nr.1, bulevard "Republika, Korçë. **Të diskutohet në mbledhjen e radhës, pasi Këshilli Shkencor, të shohë reflektimin e vërejtjeve.**

4. **Miratohet:** Projekt rikonstruksion banese individuale me pronar Ilia dhe Dion Tushi, rruga Koço Çamçe, Korçë.
5. **Miratohet:** Projekt restaurimi i banesës së Naum Dyshnikut K-010, lagjja Kala, Berat.
6. **Miratohet:** Projekt restaurim i fasadës së banesës së z. Vladimir Muçi dhe hapja e portës së vjetër, Berat.
7. **Nuk miratohet:** Projekt restaurimi i banesës së Llazar & Miti Haxhistasa K-042, lagjja Kala, Berat. **Të ngrihet një grup pune, për të studiuar gjendjen e objektit. Propozohen në grupin e punës Prof. Dr. Emin Riza, ark. Rest. Shpresa Prifti, ing. Rest. Genc Samimi, përfaqësues të IMK dhe DRKK.**
8. **Miratohet:** Projekt përshtatje e banesës së Kristaq Simsisë, lagjja Kala, Berat.
9. **Miratohet:** Projekt lehtësimi (thjeshtimi), komunikimi për hyrjen në portën e oborrit të objektit në pronësi të Kastriot Dervishi, M-116, Lagja Mangalem, Berat.
10. **Miratohet:** Projekt hapje porte në lokalin e Kostandin Plakut (ish dyqanet) K-123, lagja Kala, Berat.
11. **Miratohet:** Projekt restaurimi i banesës së Stavri Theodorit, M-083, Lagja Mangalem, Berat, **me sugjerimin,**
 - **Mbyllja e soletës të mos realizohet me kamerie.**
12. **Miratohet:** Projekt rikonstruksioni dhe përshtatje i banesës së Rajmonda Lolit, K-009/a, Lagja Kala, Berat.
13. **Nuk miratohet:** Projekt sistemimi i objektit dhe oborrit të Thoma Mihos, përfshirë dhe Portën e Pashait”, Lagja Mangalem, Berat.
 - **Nuk miratohet shtesa e çatisë.**
 - **Nuk miratohet hapja e portës në murin rrethues të shkollës.**
 - **Të punohet dera ekzistuese e portës së Pashait.**
 - **Projekti të risillet për tu shqyrtuar në KKR, pas plotësimit të vërejtjeve.**
14. **Miratohet** Projekt përshtatja e objektit të Misir Zëre, zona tampon, lagja 10 Korriku, Berat, **me kondicionin:**
 - **Të hiqet volumi i shkallëve të jashtme.**
15. **Miratohet:** Projekti i rikonstruksionit të fragmentit të pazarit të Krujës, dyqan me pronar Z. Fazan Berhami-Krujë.

Projektet të cilat financohen nga fondi i zhvillimit të rajonit:

1. **Miratohet:** Punime restauruese dhe konservuese, qyteti antik Lissus, Lezhë.
 - Punimet të zbatohen nën vëzhgimin e ASHA-s.
2. **Miratohet:** Restaurim i qemerit (harkut) të rrëzuar në kalanë e Gjirokastrës.
3. **Nuk miratohet:** Projekt restaurimi kisha e shën Mërisë së Ristozit (faza e II), komuna Drenovë, Korçë. **Të plotësohet projekti me të gjitha detajet teknike.**
4. **Miratohet:** Projekt restaurimi banese pranë klubit "Labëria", Vlorë.
5. **Miratohet:** Projekti i vlerësimit të monumenteve antike, Grazhdan, komuna Maqellarë. Dibër.
6. **Miratohet:** Projekt restaurim kalaja e Elbasanit. Projekt rivitalizimi i kullës jugperëndimore (kthimi në muze).
7. IMK të ripunojë dhe të sjellë për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme të KKR, rregulloren e funksionimit të KKR.
 - Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
 - Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ALDO BUMÇI

SEKRETAR I KKR

AKADEMIK. APOLLON BAÇE